A.K.P.A.
Nr 2898 Prot.
Datë,më 02.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HERMANN GMEINER", TIRANË

Nr34 Prot. **Tiranë më 02/11/2026**

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerezore, perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit te vazhduar profesional te personelit", i ndryshuar në Udhëzimin Nr.4, datë 18.08.2025, i ndryshuar në Udhëzimin Nr.4, datë 04.03.2026

Shkolla e Mesme Profesionale "Hermann Gmeiner", Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1 (një) mësues të Teorisë dhe Praktikës Profesionale për Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, zëvëndësim leje lindje;

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posacme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kulifikimin profesional të kërkuar;
b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- cetifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre.
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës .
09/11/2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 27.5.2024,"Për mënyrën e organizimit të veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit', i ndryshuar.

DREJTORE

HEDIE GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MESME E PROFESIONALE "HERMANN GMEINER" TIRANË